


Statistikat e Pagave

Tremujori IV / 2024

Tiranë, më 11 Mars 2025: Paga mesatare mujore bruto¹ për një të punësuar me pagë, gjatë tremujorit të katërt 2024, është 83.401 lekë, duke u rritur me 11,2 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2023.

Fig. 1 Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri (lekë) ²




Gjatë tremujorit të katërt 2024, aktivitetet ekonomike që ofrojnë pagë mesatare mujore bruto, më të lartë se paga mesatare në nivel kombëtar, janë Aktivitetet Financiare dhe të Sigurimit dhe Informacioni dhe Komunikacioni.

¹ Në llogaritjen e pagës mesatare mujore bruto përfshihen vetëm numri i të punësuarve kontribues me pagë të cilët punojnë 18 apo më shumë ditë gjatë muajit referencë. Këta kontribues i përkasin të gjithë aktivitetëve ekonomike përfshi dhe aktivitetin e Bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit që deklarohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (shih shënimin metodologjik).

² Shpërblimet dhe shtesat mbi pagë janë një pjesë e pagës mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë, të cilat në fund të çdo gjashtëmujori rrisin ndjeshëm pagën mesatare mujore bruto (shih shënimin metodologjik).


Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, gjatë tremujorit të katërt 2024, paga mesatare mujore bruto për grup aktivitetin “Ndërtim”, ka rritjen më të madhe prej 14,9 %, ndërsa rritjen më të vogël e ka grup aktiviteti “Informacioni dhe komunikacioni” prej 5,9 %.

Fig. 2 Paga mesatare mujore bruto sipas aktiviteteve ekonomike (lekë)



Gjatë tremujorit të katërt 2024, grup profesionet “Manaxherë, Ligjvënës, Nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorë ekzekutivë” dhe “Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)”, ofrojnë pagat mesatare mujore bruto më të larta, krahasuar me pagën mesatare mujore në nivel kombëtar.

Fig. 3 Paga mesatare mujore bruto sipas grup-profesioneve



Tab. 1 Paga mesatare mujore bruto dhe paga minimale e miratuar

Përshkrimi	IV/21	I/22	II/22	III/22	IV/22	I/23	II/23	III/23	IV/23	I/24	II/24	III/24	IV/24
Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë	59.565	59.242	60.666	61.613	66.014	64.706	70.905	71.486	75.025	73.641	75.114	77.669	83.401
Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë në sektorin shtetëror	70.531	67.045	68.245	70.593	74.450	73.205	82.207	84.318	87.864	84.979	85.901	96.856	100.437
Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë në sektorin privat	54.482	55.638	57.327	57.613	62.198	60.943	65.901	65.975	69.400	68.686	70.430	69.534	76.000
Paga minimale e miratuar	30.000	30.000	32.000	32.000	34.000	34.000	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000	40.000

Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore; Llogaritje të INSTAT

Tab. 2 Paga mesatare mujore bruto sipas grup-aktiviteteve ekonomike

NVE Rev2 (seksion)	Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev2	IV/21	I/22	II/22	III/22	IV/22	I/23	II/23	III/23	IV/23	I/24	II/24	III/24	IV/24
	Gjithsej	59.565	59.242	60.666	61.613	66.014	64.706	70.905	71.486	75.025	73.641	75.114	77.669	83.401
A	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	35.881	38.445	40.044	41.205	42.428	43.903	47.068	47.648	49.140	49.594	50.134	50.951	54.411
B,C,D,E	Industria gjithsej	51.104	50.682	53.266	53.551	57.079	57.720	61.117	61.570	64.381	65.040	65.093	65.433	69.698
F	Ndërtimi	44.949	46.953	48.210	49.062	51.025	51.465	56.117	57.080	58.367	58.706	59.721	60.526	67.079
G,H,I	Tregtia; transporti; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor	45.988	46.987	48.630	49.434	53.178	52.436	56.758	57.328	60.779	60.139	60.682	61.072	67.548
J	Informacioni dhe komunikacioni	90.707	101.564	96.789	93.910	103.520	103.215	112.114	105.585	114.761	110.364	123.299	114.362	121.578
K	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	122.106	114.334	130.872	119.135	142.141	119.206	149.091	132.686	148.597	133.982	166.068	138.715	163.223
L,M,N	Aktivitete të pasurive të paluajtshme; Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse	66.055	66.975	67.129	68.768	73.543	72.662	76.444	79.300	82.630	82.023	82.461	82.806	88.813
O,P,Q	Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	70.694	68.048	68.389	71.675	75.059	73.201	82.319	84.992	87.249	84.429	84.793	97.281	100.078
R,S,T,U	Arte, argëtim dhe çlodhje; Aktivitete të tjera shërbimi	64.854	62.142	64.061	65.024	69.168	66.332	71.747	72.661	76.410	73.707	74.781	75.400	82.019

Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore; Llogaritje të INSTAT

Tab. 3 Paga mesatare mujore bruto sipas grup-profesioneve ekonomike

Grup-profesionet sipas ISCO-08	IV/21	I/22	II/22	III/22	IV/22	I/23	II/23	III/23	IV/23	I/24	II/24	III/24	IV/24
Gjithsej	59.565	59.242	60.666	61.613	66.014	64.706	70.905	71.486	75.025	73.641	75.114	77.669	83.401
Manaxherë, Ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorë ekzekutivë	102.304	102.853	102.156	100.256	109.465	104.483	116.627	116.176	122.097	118.699	122.465	122.159	130.859
Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)	79.476	78.288	79.925	82.374	86.542	85.007	92.566	93.963	97.520	95.307	97.548	104.995	111.331
Teknikë dhe specialistë në zbatim	67.711	66.377	67.437	68.749	72.863	71.331	77.127	78.481	82.277	80.515	82.123	86.379	92.040
Nëpunësit	62.410	62.406	63.363	63.544	69.219	67.326	71.363	73.021	76.831	75.083	77.356	76.790	84.395
Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve	45.157	44.626	45.751	46.732	50.279	49.413	54.678	54.942	57.887	56.386	56.929	59.842	62.610
Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit	36.691	37.929	39.832	40.615	42.915	42.646	47.413	47.620	48.689	48.539	47.684	47.660	51.093
Zejtare, artizanë dhe profesione të lidhura me to	41.602	41.803	43.810	44.515	47.130	47.192	51.460	51.728	54.000	54.133	54.886	55.306	60.817
Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve	42.514	42.760	45.495	46.253	49.272	48.958	52.924	53.223	55.950	55.366	56.636	56.980	61.891
Punëtorë (Profesione elementare)	35.097	36.281	38.620	39.402	41.572	41.387	46.387	47.029	48.368	48.131	48.698	49.257	53.421
Forcat e armatosura	70.493	65.303	65.359	77.362	78.837	79.568	86.236	86.454	87.172	86.330	86.397	98.163	98.435

Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore; Llogaritje të INSTAT

Metodologjia

Publikimi i të dhënave për pagat përmbajnë të dhëna të detajuara për nivelin e pagave, shpërndarjes dhe ndryshimin e tyre përgjatë tremujorëve. Këto statistika ofrojnë një mundësi për të krahasuar pagat në industri të ndryshme dhe në grup-profesione të ndryshme. Statistikat mbi pagat janë gjithashtu të një rëndësie të veçantë për monitorimin e treguesve ekonomikë që përdoren nga politikë-bërësit, punëdhënësit dhe sindikatat për të vlerësuar kushtet e kërkesës dhe të ofertës për punë.

Baza ligjore

- Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare;
- Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026.
- Memorandimi i Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Burimi i informacionit

Burimi i të dhënave mbi pagat është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bazë të memorandumit të bashkëpunimit i dërgon INSTAT-it, të dhënat nga Listëpagesa (E- SIG 025).

Ky formular shërben për deklarimin e tre llojeve të detyrimeve tatimore :

- Të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore,
- Të Kontributeve të Sigurimeve Shëndetësore,
- Të Ardhurave nga Punësimi për punëmarrësit.

Variablat e skedarit janë tre lloje: variablat e skedarit origjinal nga DPT, variabla shtesë nga INSTAT dhe variabla të derivuar. Dy variablat kryesorë të interesit në këtë skedar janë Numri i punonjësve dhe Paga bruto paguar punëmarrësit.

Përkufizime

Paga mesatare mujore - Në llogaritjen e pagës mesatare mujore bruto përfshihen vetëm numri i të punësuarve kontribues me pagë të cilët punojnë 18 apo më shumë ditë gjatë muajit referencë. Këta kontribues i përkasin të gjithë aktiviteteve ekonomike përfshi dhe aktivitetin e Bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit që deklarohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Paga mesatare mujore bruto përbëhet nga:

- Shtesa mbi pagë për funksione drejtuese
- Shtesa mbi pagë për vjetërsi në punë
- Shtesa mbi pagë për vështirësi në punë
- Shtesa të tjera të rregullta (tituj, grada etj.)
- Shpërblime

Në pagën mesatare mujore bruto nuk zbriten kontributet personale dhe tatimi mbi të ardhurat.

Paga minimale mujore - është paga më e ulët e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kontribues me pagë në sektorin e Bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit - konsiderohen të gjithë të punësuarit me pagë të deklaruar nga fermat/ndërmarrjet bujqësore të rregjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Klasifikime

- Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev. 2, si më poshtë:

NVE Rev.2 (Seksioni)	Përshkrimi
A	Bujqësia, pyjet, peshkimi
B	Industria nxjerrëse
C	Përpunimi
D	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve
F	Ndërtimi
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave
H	Transporti dhe magazinimi
I	Akomidimi dhe shërbimi ushqimor
J	Informacioni dhe komunikacioni
K	Aktivitete financiare dhe të sigurimit
L	Aktivitete të pasurive të paluajtëshme
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike
N	Shërbime administrative dhe mbështetëse
O	Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm
P	Arsimi
Q	Shëndetsia dhe aktivitete tëpunës sociale
R	Arte, argëtim dhe çlodhje
S	Aktivitete të tjera shërbimi
T	Aktivitetet të familjeve si punëdhënës; Aktivitete të prodhimit të mallrave e shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorimin e vet
U	Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare

- Klasifikimi i profesioneve është bërë sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Profesioneve, ISCO-08, si më poshtë:

ISCO_08	Përshkrimi
1.	Manaxher
2.	Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)
3.	Teknikë dhe specialistë në zbatim
4.	Nëpunësit
5.	Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve
6.	Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit
7.	Zejtare, artizanë dhe profesione të lidhura me to

ISCO_08	Përshkrimi
8.	Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve
9.	Punëtorë (Profesione elementare)
0.	Forcat e Armatosura